



## **VENDIMI I PAPRANUESHMËRISË**

**Data e miratimit: 8 dhjetor 2010**

**Nr. i rastit 2010 - 16**

**Zonja Cyma Agovic**

Kundër

**EULEX-it**

Paneli për Rishikimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 8 dhjetor 2010, me personat e pranishëm të paraqitur në vijim:

Zotëri Antonio BALSAMO, Kryesues i Panelit  
Zonja Magda MIERZEWSKA, anëtare  
Zotëri Francesco FLORIT, anëtar

Asistuar nga  
Zotëri John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Zonja Leena LEIKAS, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it i 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Rishikimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullave në Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PARA PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar në EULEX më 16 gusht 2010 dhe iu është përcjellë Panelit më 6 tetor 2010.

## **II. FAKTET**

### **Parathënie**

2. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) është themeluar në vitin 2002 për të përgatitur privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh) dhe administrimin e Ndërmarrjeve Publike (NP).
3. Gjatë procesit të privatizimit, AKM-ja publikon një listë të punëtorëve të kualifikuar që kanë të drejtë të marrin një pjesë të të hyrave nga privatizimi i kompanisë në fjalë. Një listë e tillë ishte botuar në media.
4. Sipas seksionit 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut (RrEG) 2003/13 një person mund të bëjë kërkesë tek Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit për të rishikuar listën e personave të kualifikuar, e cila është përpiluar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM). Një kërkesë e tillë është dashur t'i dorëzohet Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës brenda 20 ditëve pas publikimit përfundimtar në media të listës së Agjencisë.
5. Sipas Nenit 117 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), nëse një palë nuk ndërmerr ndonjë veprim në proces brenda afatit, dhe si pasojë e saj humbet e drejta të ndërmerret ai veprim, gjykata mundet me kërkesë të palës, dhe nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, të lejon të ndërmerret veprimi. Sipas Nenit 118 të LPK, një mocion i tillë për kthim në pozitën e mëparshme duhet të dorëzohet brenda 15 ditësh nga dita kur arsyet për mosveprim nuk ekzistojnë. Afati i fundit kohor për një mocion të tillë është tre muaj nga afati fillestar.
6. Në rastet ku përfshihet Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme, një mocion i tillë për kthim në gjendjen e mëparshme duhet të bëhet tek Paneli për Ankesa i Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme.

### **Faktet**

7. Ankuesi ka punuar në lavanderi të Hotelit Rugova në Pejë nga viti 1978 deri në vitin 1999, gjithsej diku 21 vite.
8. Në korrik të vitit 2003 është mbajtur një takim në mes të punëtorëve dhe Sindikatës së Punëtorëve të Ndërmarrjes Rugova. Një vendim ishte marrë që të lejohen të gjithë punëtorët të kenë të gjitha të drejtat që dalin nga kontratat e punësimit, përfshirë të drejtën në procesin e privatizimit, edhe nëse ata nuk kanë qenë duke marrë pagat, apo nëse nuk kanë qenë të caktuar në ndonjë pozitë.
9. Sipas rregulloreve mbi procedurat e privatizimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, punëtorët e kualifikuar kanë të drejtë në 20% prej të hyrave nga privatizimi.

10. Lista e punëtorëve të kualifikuar që kanë të drejtë në 20% ishte përpiluar nga Drejtoria e Hotelit më 3 shtator 2003. Ankuesi ishte përfshirë në atë listë të punëtorëve të cilët kanë qenë në listën e pagave për më shumë se tre vite para luftës, mirëpo të cilët nuk kanë qenë të caktuar në asnjë pozitë pune, për shkak se objektet e Hotelit kanë qenë të djegur gjatë luftës dhe më vonë ishin zënë nga KFOR-i. Në listë konstatohet se ajo ka qenë e punësuar që nga viti 1978, dhe se kontrata e saj e punës nuk ishte ndërprerë, dhe se ajo nuk kishte përvojë pune pas vitit 1999. Kjo listë i ishte përcjellë AKM-së për procedim më 3 shtator 2003.
11. AKM-ja ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore "Rugova" në Pejë më 7, 8, 10 dhe 11 maj 2008. Si pasojë, afati i fundit për dorëzimin e ankesave ka përfunduar më 2 qershor 2008.
12. Ankuesja ka dorëzuar një ankesë tek Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme më 6 maj 2009. Ankesa e saj ishte hedhur poshtë si e papranueshme më 9 korrik 2009 nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme në përputhje me Seksionin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/03 pasi kishte dorëzuar ankesën e saj tek Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme pas skadimit të afatit të paraparë për ankesa, d.m.th. 2 qershor 2008.
13. Më 12 gusht 2009, ankuesja ka dorëzuar një ankesë tek Paneli për Ankesa në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme për ta hedhur poshtë vendimin e mëparshëm dhe të kthehet në pozitën e mëparshme pasi ajo ishte shtrirë në spital në kohën kur ankesa duhet të ishte dorëzuar.
14. Ankuesja ka paraqitur dokumentet tek Paneli për Ankesa në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, dokumente të cilat kanë treguar se ajo ishte trajtuar si një paciente e vendosur në spital prej 4 deri më 14 prill 2008 dhe prej 25 deri më 28 maj 2009. Më 29 maj 2009 ajo ishte trajtuar në një spital në Beograd.
15. Më 8 maj 2010 Paneli i Ankesave i Dhomës së Veçantë i Gjykatës Supreme ka hedhur poshtë ankesën e saj pasi fillimisht ajo kishte dorëzuar ankesën e saj shumë vonë dhe vendimi i Dhomës së Veçantë i Gjykatës Supreme sa i përket kësaj ishte në rregull. Mocioni i saj në kthim në gjendjen e mëparshme, në përputhje me Nenin 118 të LPK, duhet të ishte dorëzuar brenda tre muajve nga afati fillestar më së voni, kështu jo më vonë se data 2 shtator 2008. Gjithashtu edhe mocioni ishte hedhur poshtë.
16. Ankuesja ka dërguar një letër tek Shefi i Misionit të EULEX-it më 16 gusht 2010. Shefi i Misionit e kishte përcjellë këtë ankesë tek PShDNj për shqyrtim me letrën e datës 30 shtator 2010.

### **III. ANKESAT**

17. Ankuesja pretendon se ajo ka qenë e diskriminuar në lidhje me beneficionet që kanë të bëjnë me punën e saj, si dhe fakti se sëmundja e saj nuk ishte marrë parasysh kur mocioni i saj ishte shqyrtuar.

### **IV. LIGJI**

1. Para shqyrtimit të ankesës lidhur me bazueshmërinë e ankesës, Paneli duhet të vendos se a ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin për pranueshmëri të ankesës të përcaktuar në Rregulloren 29 të Procedurës së Punës.
2. Sipas Rregullore 25, paragrafi 1 i Rregullore së Punës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv. Paneli nuk do t'i shqyrtoj procedurat gjyqësore para gjykatave në Kosovë.
3. Rasti i ankueses lidhet me faktin se ankesa e saj ishte hedhur poshtë nga Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme dhe nga Paneli për Ankesa i Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme pasi ata kanë konstatuar se afati për dorëzimin e ankesës kësaj kishte skaduar.
4. Ankesa e tanishme ka të bëjë me procedurat juridike që janë kryer nga gjykatat e Kosovës. Prandaj, Paneli konstaton, sipas Rregullore 25 të Rregullore së Punës së vet, se mungon juridiksioni për ta shqyrtuar ankesën e tanishme.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se kjo ankesë është e pabazuar, dhe

### **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor

Antonio BALSAMO  
Kryesues i Panelit